



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të procedimit penal Nr. 19/1, të vitit 2024, me të pandehur **Rexhep Rapi** (alias Kep Arapi), **Algert Rapi**, **Dedan Gjoni** dhe **Dejvi Gjermëni** (alias Elton Gjermëni, alias Elton Gjermëni, alias Sako Gjermëni)”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Bani, Flora Hajredinaj dhe Rudina Palloj, me vendimin Nr. 62, datë 21.10.2024 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Rexhep Ramazan Rapi** (alias **Kep Arapi**), për kryerjen e veprës penale të “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit Xh.P, kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 80 dhe në lidhje e nenin 28/4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Rexhep Ramazan Rapi** (alias **Kep Arapi**) për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 333/a paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.
3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Rexhep Ramazan Rapi** (alias **Kep Arapi**), dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Rexhep Ramazan Rapi** (alias **Kep Arapi**), i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet burgim**.
5. Vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Rexhep Ramazan Rapi** (alias **Kep Arapi**) në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 81/2020 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Algert Hamdi Rapi**, për kryerjen e veprës penale të “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit Xh.P, kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe*

- grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 80 dhe në lidhje e nenin 28/4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Algert Hamdi Rapi** për kryerjen e veprës penale "*Grupi i strukturuar kriminal*" parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
 8. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Algert Hamdi Rapi**, dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet burgim**.
 9. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Algert Hamdi Rapi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim**.
 10. Vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Algert Hamdi Rapi** në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 81/2020 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”.
 11. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dedan Ndue Gjoni**, për kryerjen e veprës penale të “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit Xh.P, kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 80 dhe në lidhje e nenin 28/4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.
 12. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dedan Ndue Gjoni**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
 13. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Dedan Ndue Gjoni**, dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet burgim**.
 14. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Dedan Ndue Gjoni**, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim**.
 15. Vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Dedan Ndue Gjoni**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 81/2020 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”.
 16. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dejvi Llazi Gjermëni**, (alias Elton Gjermëni alias Elton Gjermëni alias Sako Gjermëni), për kryerjen e veprës penale të “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit Xh.P, kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 80 dhe në lidhje e nenin 28/4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.
 17. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dejvi Llazi Gjermëni** për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
 18. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Dejvi Llazi Gjermëni**, dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet burgim**.

19. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Dejvi Llazi Gjermëni**, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim**.
20. Vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Dejvi Llazi Gjermëni** në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 81/2020 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”.
21. Shpenzimet proceduriale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidarë.
22. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 21.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar